



700

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
LEZHË

Adresa: Lagjia «Besëlidhja», Lezhë. Tel.& fax: +35542222322

K Ë R K E S Ë
“PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE”

Në Lezhë, viti 2015, muaji Maj, data 19.

Unë, **Erjon SHEHAJ**, Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi studiova aktet e procedimit penal nr. 615 të vitit 2013, që bëjnë fjalë për veprën penale të «Pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale», të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal,

K O N S T A T O V A:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, mbi bazën e materialit të referuar nga Drejtoria e Policisë Qarkut Lezhë dhe pas verifikimeve paraprake të kryera, më datën 09.10.2013 ka regjistruar procedimin penal nr. 615 të vitit 2013, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal në ngarkim të shtetasit **Astrit NIMANI**, alias **Astrid LIMANI**, i biri i Uk dhe i Rushe, i datëlindjes 18.04.1971, lindur dhe banues në Lezhë.

Si indicie për fillimin e procedimit penal ka shërbyer informacioni i dërguar nga Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar.

Sipas informacionit të disponuar rezulton se: *“ky shtetas eshte i shpallur ne kerkim nderkombetar, pasi Gjykata e Milanos-Itali, me Vendimin Nr. 3558/2011 SIEP, date 26.09.2011, e ka dënuar këtë shtetas me 7 (shtatë) vjet heqje lirie, për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”.*

Krahas informacionit të dërguar nga Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar, Tiranë i është kërkuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Lezhë :

Identifikimi i pasurive të luajshme apo të paluajshme si dhe bizneset, që ky shtetas dhe familjarët e tij i kanë faktikisht, por të regjistruar në emra të tjerë.

Nga veprimet paraprake të kryera nga D.P.Qarkut, Lezhë, rezulton se:

Shtetasi Astrid Limani, i biri i Uk dhe i Rushe, i dtl. 18.04.1971, lindur ne Lezhe dhe banues ne lagjen “Varosh” Lezhe, i martuar, me kombesi e shtetesi shqiptare, ka bere ndryshimin e gjeneraliteteve nga **Astrit Nimani** ne **Astrid Limani** dhe se janë identifikuar paraprakisht pasuritë e mëposhtme:

- 1(një) objekt në qytetin e Shengjinit të quajtur “Ermiri Palace” me sherbime Bar-Restorant-Hoteleri 3.5 katesh.
- 1(një) lokal ne formen e pistes në det, perballë hotelit “Ermiri Palace”.
- 1(një) pallat 10(dhjetë) katesh ngjitur me objektin e mesiperm te cilin sipas burimeve te sigurta nuk e ka te regjistruar dhe me lejen perkatese.
- 1(një) pallat 15(pesëmbëdhjetekatesh) te perfunduar dhe te shitur si apartamente banimi
- 1(një) pallat 12(dymbëdhjetekatesh) te perfunduar e shitur si apartamente banimi ne zonen turistike te Shengjinit.
- 1 (një) vilë banimi ne lagjen “Varosh” te bashkise Lezhë rreth 150 meter larg Spitalit Rajonal Lezhe.
- 150 shezlongje te kompletuara e te vendosura ne reren e plazhit para hotelit te siperpermendur.

Objektet e lartpermendura si dhe kompleksi turistik “Ermiri Palace” gjenden te ndërtuara ne nje vije te drejte me njera tjetren ne qytetin e Shengjinit te rrethit Lezhë.

Gjithashtu ky shtetas ka në pronesi:

- 1(nje) autoveture tip fuoristrade luksoze te tipit “Audi Q7” me targe TR 3636 T, ku nga verifikimi i saj rezulton se eshte ne pronesi te subjektit “ Raifeisen Bank”.
- 1(një) Jaht turistik luksoz, i cili është i ankoruar ne det ne afersi te kompleksit turistik te quajtur “Ermiri Palace”ne qytetin e Shengjinit. Ky jaht quhet “Ermiri Palace”.
- 2(dy) skafe me mbishkrimin “Ermiri Palace”, te cilat perdoren per shetitje turistike ne det.

Për të verifikuar nëse ekziston vepra mëmë dhe nëse ka rekorde kriminale në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur me dy gjeneralitetet, që do të mundësonte fillimin e procedimit penal për vepren penale te “Pastrimit te Produkteve te Vepres Penale ose veprimtarise kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, i është kërkuar informacion Zyrës Ndërlidhëse së Policisë Italiane me Shqipërinë, Interforce, Tiranë.

Në përgjigjen e ardhur rezulton:

Shtetasi **Astrit NIMANI** ka ndryshuar gjeneralitetet ne **Astrid LIMANI**, i biri i Uk dhe Rushe lindur ne Lezhe me 18.04.1971, posedues i pasaportes shqiptare me nr. BE0017656, e leshuar me date 23.08.2012. Duke konsideruar faktin qe Interpol Tirana ka komunikuar qe shtetasi i cituar ne lende ndodhet ne Shqiperi prane baneses se tij, dhe eshte pronar i Hotelit ERMIRI PALACE, Lezhe, Shengjin por qe nuk mund ta arresroje me qellim ekstradimin ne drejtim te Italise pa nje perditesim te shpalljes ne kerkim me gjeneralitetet e reja, Zyra jone Qendrore ne Rome ka informuar Autoritetin Gjyqesor kompetent Italian, me qellim qe te shtrije urdher arrestin ne fushe nderkombetare me qellim ekstradimin e ketij subjekti ne drejtim te Italise me gjeneralitetet e reja, duke qene se ne ngarkim te tij eshte leshuar:

a. Masa e sigurise arrest ne burg nr. 784/2007 R.G.G.I.P - N 6167/07 R.G.N.R me date 13.02.2007 nga Gjykatesi per Hetimet Paraprake prane Gjykates ne Milano per trafik ledesh narkotike te kryer ne bashkepunim (masa i eshte ngarkuar per ekzekutim Qendres se P.T.Gdf-GOA Torino);

b. Masa e sigurise arrest ne burg nr. 1057/2007 RGNR - nr. 1465/05RGGIP e Gjykates ne Lucca-Zyra e Gjykatesit per Hetimet paraprake, me date 31.05.2005 per shkelje te ligjit mbi lendet narkotike-**Operacioni "Red Horse"**, (masa i eshte ngarkuar per ekzekutim Compagnia Carabinieri N.O.R.M ne Lucca").

"I njejt i eshte identifikuar nga G.O.A Gdf ne Milano ne vijim te pergjimeve telefonike te disa numrave celular Italian, ku njeri prej tyre rezulton i regjistruar ne emer te te njejt.

-Ne kuader te pergjimeve, Astrit NIMANI, nder te tjerash, ka kontaktuar numrin telefonik shqiptar nr. 00355682531039 ne perdorim te babait. Ne veçanti me date 26.12.2002 me rastin e kthimit te tij ne Shqiperi me anijen "MILLENIUM STAR" nga Bari ne Durres, i njejt ka komunikuar qe nuk kishte nevojë qe ta merrte vellai, Erjoni, nga Durresi pasi shoku i tij i udhetimit Luan SUFJA kishte marre masat duke therritur nje shokun e tij;

-Nga lista e imbarkimeve ne tragetin ne fjale, rezulton qe ndermjet pasagjereve kane qene te regjistruar ne liste edhe nje fare Luan SUFJA, lindur me 08.01.1975 ne Lezhe (Shqiperi) posedues i pasaportes Z0027720 dhe Astrit NIMANI lindur ne Lezhe (Shqiperi) me 18.04.1971 titullar i pasaportes nr. 10051837.

-Nga aktet e hetimit "RED HORSE" e kryer nga NORM i Compagnia Carabinieri ne Lucca (shkurt - qershor 2004) rezulton qe ne ate kohe Astrit NIMANI ishte nje banues i perhershem ne Prage ne nje apartament te vendosur ne sheshin me te madh te qytetit te quajtur si "CENTRUM", ne katin e dyte te nje pallati nga ana e kundert e sheshit ne fjale, perballe hyrjes ne qendren me te madhe tregtare /supermarket te qytetit ne kohen e hetimeve. Ky shtetas ka patur ne perdorim numrat e meposhtem çek:

a. 0042022224492 (telefon public i vendosur ne Praga Vaclavske Nemesti nr. 846 int.1),

b. 00420608843405 (skede telefonike e parapaguar e aktivizuar me date 19.02.2004),

c. 004206083341838 (skede telefonike e parapaguar e aktivizuar me date 20.01.2004),

Identifikimi i shtetasit **Astrit NIMANI** eshte kryer fale deklarave te dhena nga shtetasi Italian **Antonio DELLA LATTA**, lindur ne Camaiole me 30.08.1958, i arrestuar ne kuader te operacionit ne fjale, pasi rezulton te jete korrieri i lendes narkotike per llogari te NIMANIT. Nga deklaratat e dhena nga ky shtetas ka treguar qe e ka njohur Astrit NIMANI-n prane hotelit ne pronesi te familjes NIMANI ne Shengjin, emrin e te cilit nuk e njihte, dhe qe ne ate kohe ishte hoteli i pare ne bregdet qe dallohej sapo hyje ne qytet, rreth 3 kilometra larg hotelit « PRESIDENT».

78)

Pas veprimeve të lartpërmendura më datë 02.10.2013 janë referuar materialet e para hetimore në ngarkim të shtetasit: **Astrit NIMANI**, alias **Astrid LIMANI**, i datelindjes 18.04.1971, lindur dhe banues ne Lezhë, i dyshuar për veprën penale të "Pastrimit të Produkteve të Vepres Penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Mbi bazën e materialit referues, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ka regjistruar procedimin penal Nr. 615, datë 09.10.2013, në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur për veprën penale të "Pastrimit të Produkteve të Vepres Penale ose të veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Bazuar në urdhërin e delegimit të datës 28.02.2014, nga ana e Oficerëve të Policisë Gjyqësore janë kryer veprimet e mëposhtme:

-Me shkresën nr. 3107 Prot, datë 26.03.2014, i është kërkuar informacion Zyrës Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana, nëse shtetasi i lartpërmendur ka precedent kriminal apo është i dënuar nga gjykata si dhe pronat, që mund të ketë në shtetet, ku ai dyshohet se ka kryer veprimtarinë kriminale.

Në përgjigje të saj, Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana, informon se: "Shtetasi Astrid Limani, ka qënë i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol-Roma, Itali pasi Gjykata e Milanos, me Vendimin Nr. 784/2007 RGGIP.N.6167/07 RGNR, datë 22.02.2007, ka lëshuar Urdhër-Arrestin Ndërkombëtar për këtë shtetas, për kryerjen e veprës penale të bashkëpunimit kriminal me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike, parashikuar nga nenet 81 dhe 110 të Kodit Penal Italian. Aktualisht kërkimi për këtë shtetas është anuluar, pasi është arrestuar më datë 15.11.2013, në Serbi dhe më datë 20.12.2013 është ekstraduar drejt Italisë".

-Me shkresën Nr. 3091 Prot, datë 26.03.2014, i është kërkuar Zyrës së Gjendjes Civile të Rrethit Lezhë informacion dhe vënien ne dispozicion të Çertifikatës së Trungut Familjar për shtetasin **Astrit NIMANI** dhe bashkëshorten e tij, Çertifikatat Personale e Familjare per secilin person te dale nga Çertifikatat e Trungut Familjar.

Me shkresën Nr. 14 Prot, datë 11.04.2014, Zyra e Gjendjes Civile e Rrethit Lezhë ka informuar mbi përbërjen familjare dhe ka dërguar çertifikatën familjare me Nr. 005310022, në bazë të regjistrit 1950 të vitit 1950-1974. Bashkëlidhur është edhe kopje e fletës së regjistrit themeltar të shtetasve.

-Me shkresën Nr. 10889 Prot. datë 24.12.2013, është kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkisë Lezhë dhe vënien ne dispozicion për **Astrit NIMANIN**, Çertifikatat Personale e Familjare për këtë shtetas.

Me shkresë Nr.961Prot, datë 31.12.2013 Zyra e Gjendjes Civile të Bashkisë Lezhë ka informuar mbi përbërjen familjare dhe personale certifikatën familjare dhe personale, në bazë të regjistrit të vitit 2010, duke na vënë në dispozicion certifikatat e kërkuara.

-I është kërkuar informacion Bankave të Nivelit të Dytë për transaksionet e kryera nga ky shtetas apo familjarët e tij si dhe gjendjen aktuale të llogarive bankare.

Me shkresën Nr. 4626 Prot. datë 28.05.2014, i është kërkuar informacion Bankës së Kreditit të Shqipërisë.

Për familjarët e shtetasit Asrit NIMANI *alias* Astrid LIMANI;

1. **Uk NIMANI**, i biri i Ismail dhe i Fatime, i datelindjes 18.07.1949, lindur në Kukës dhe banues në Lezhë (i ati).
2. **Rushe NIMANI**, e bija e Adem dhe Shahe, e datëlindjes 17.06.1952, lindur në Tropojë dhe banuese në Lezhë (e ëma).
3. **Elda NIMANI**, e bija e Pashk dhe Luke, e datëlindjes 01.05.1979, lindur në Baz, Mat dhe banuese në Lezhë (bashkëshortja).
4. **Klea NIMANI**, e bija e Astrit dhe Elda, e datëlindjes 10.07.2000, lindur dhe banuese në Lezhë (e bija).
5. **Asmireld NIMANI**, i biri i Astrit dhe i Elda, i datelindjes 28.11.2001, lindur dhe banues në Lezhë (i biri).
6. **Rei NIMANI**, i biri i Astrit dhe i Elda, i datelindjes 15.01.2008, lindur dhe banues në Lezhë (i biri).

Për të afërmit e tjerë të shtetasit Asrit NIMANI *alias* Astrid LIMANI ;

7. **Adlije NIMANI**, e bija e Ymer dhe Xhevahire, e datëlindjes 30.08.1957, lindur në Shkodër dhe banuese në Lezhë.
8. **Erjon NIMANI**, i biri i Uk dhe i Adlije, i datelindjes 30.04.1977, lindur dhe banues në Lezhë (vëllai).
9. **Ermira NIMANI**, e bija e Elez dhe Sema, e datëlindjes 24.03.1979, lindur dhe banuese në Lezhë (kunata).
10. **Ermir NIMANI**, i biri i Uk dhe i Adlije, i datelindjes 25.11.1982, lindur dhe banues në Lezhë (vëllai).
11. **Klajdi NIMANI**, i biri i Erjon dhe i Ermira, i datelindjes 10.01.2003, lindur dhe banues në Lezhë (nipi).
12. **Klara NIMANI**, e bija e Erjon dhe Ermira, e datelindjes 05.10.2005, lindur dhe banuese në Lezhë (mbesa), Nuk kanë llogari bankare dhe nuk kanë kryer llogari bankare.

-Me shkresën Nr. 4620 Prot. datë 28.05.2014 i është kërkuar informacion Bankës Veneto.

Në përgjigjen Nr. 10253/1 Prot. datë 03.06.2014 të Bankës së Veneto, informon se: Shtetasit e mësipërm nuk kanë patur asnjë mardhënie me bankën tonë.

-Me shkresën Nr. 4613 Prot. datë 28.05.2014 i është kërkuar informacion Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.

Në përgjigjen me Nr. 583/14, datë 03.06.2014 të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, informon se: Shtetasit e mësipërm nuk kanë patur asnjë mardhënie me bankën tonë.

-Me shkresën Nr. 4621 Prot., datë 28.05.2014 i është kërkuar informacion Bankës Union.

Në përgjigjen me Nr. 3140/1 Prot. datë 03.06.2014 të Bankës Union, informon se:

Shtetasit e mësipërm nuk janë klientë të kësaj banke.

-Me shkresën Nr. 4625 Prot. datë 28.05.2014 i është kërkuar informacion Bankës Emporiki.

Në përgjigje Nr. 6386-14-NDS, datë 04.06.2014 të bankës Emporiki, informon se: Shtetasit e mësipërm nuk mbajnë llogari në bankën tonë.

-Me shkresën Nr. 4616 Prot., datë 28.05.2014 i është kërkuar informacion Bankës ALPHA.

Në përgjigjen Nr. 08471 Prot, datë 04.06.2014 të Bankës Alpha, informon se:

Vetëm shtetasi Astrit Nimani ka patur llogari pranë kësaj banke, ku thekson se balanca e tij është zero.

-Me shkresën Nr. 4614 Prot., datë 28.05.2014 i është kërkuar informacion Bankës Ndërkombëtare Tregtare.

Në përgjigjen Nr. ON-A-7295/2014Prot, datë 04.06.2014 të Bankës Ndërkombëtare tregtare, informon se: Shtetasit e sipërcituar nuk janë klient të bankës tone.

-Me shkresën Nr. 4615Prot., datë 26.05.2014 i është kërkuar informacion Bankës së Parë të Investimeve.

Në përgjigjen Nr. 7958, Prot, datë 04.06.2014 të Bankës Parë të Investimeve informon se: Shtetasit e sipërcituar nuk janë klient të bankës tone.

-Me shkresën Nr. 4623 Prot, datë 28.05.2014 i është kërkuar informacion Bankës Raiffeisen.

Në përgjigjen me Nr. 10966/1 Prot, datë 05.06.2014 të Bankës Raiffeisen, informohemi se: Shtetasi Astrit Uk Nimani ka llogari rrjedhëse në valutë dhe gjendja aktuale është 057, Euro. Shoqëria "Kalaja Impex", ka llogari rrjedhëse me gjendje aktuale 1347 Lekë.

Ka llogari rrjedhëse në valutë. Aktualisht kjo llogari është më gjendje debitore në shumën 149991 Euro për shkak të overdraftit të marrë në bankë.

Subjekti rezulton kredi marrës pranë bankës më datë 01.07.2013 në shumën 233 804 euro. Aktualisht detyrimi i pashlyer i kredisë është 209 298 euro.

Shtetasja Elda Nimani ka qënë kliente pranë kësaj banke, filiali Lezhe. Klientja ka patur llogari rrjedhëse në lek për tërheqjen e pagës mujore, e cila aktualisht është e mbyllur.

Shtetasja Adlie Nimani është kliente pranë kësaj banke. Klientja disponon llogarite e mëposhtëme:

Ka llogari rrjedhëse në lekë gjendje aktuale 5 267 lekë

Ka llogari rrjedhëse në valutë me gjendje aktuale 0.02 euro.

Shtetasi Erion Nimani është klient pranë kësaj banke:

Ka llogari rrjedhëse në lekë në gjendje aktuale zero lekë.

Ka llogari rrjedhëse në valutë me gjendje aktuale 49 155 euro.

Personat e tjerë nuk jane klient të kësaj banke.

-Me shkresën Nr. 4619Prot., dt. 28.05.2014 i është kërkuar informacion Bankës Pro Credit.

Në përgjigje Nr. OP-10424/1, Prot. datë 04.06.2014 të Bankës ProCredit, informon se:

Shtetasi Astrit Nimani nuk ka llogari bankare në këtë bankë. Ky shtetas ka patur llogari bankare të hapur prej datës 18.03.2005 deri më datë 24.08.2006, gjendja aktuale zero.

Shtetasi Uk Nimani nuk ka llogari bankare në këtë bankë pasi është i vdekur. Ky shtetas ka patur llogari bankare të hapur prej datës 22.08.2003 deri më datë 18.03.2005. gjendja aktuale është zero.

Shtetasja Adlie Nimani nuk ka llogari bankare në këtë bankë. Kjo shtetase ka patur llogari bankare të hapur në euro dhe lekë dhe gjendja aktuale është zero.

Shtetasi Erion Nimani nuk ka llogari bankare në këtë bankë. Ky shtetas ka patur llogari bankare të hapur prej datës 18.03.2005 deri më dt. 24.08.2006, gjendja aktuale është zero.

-Me shkresën Nr. 4611 Prot., datë 28.05.2014, i është kërkuar informacion Bankës Intesa San Paolo.

Në përgjigjen Nr.14/2604/1 Prot, dt. 06.06.2014 të Bankës Intesa San Paolo, informon se: Shtetasi Astrit Nimani ka patur llogari në lekë, euro e dollarë pranë kësaj banke. Ka patur disa lëvizje bankare dhe aktualisht llogaria gjendet e mbyllur. Gjendja aktuale ne llogari, eshte zero.

-Me shkresën Nr. 4627 Prot., datë 28.05.2014, i është kërkuar informacion Bankës Popullore (Societe Generale Albania).

Në përgjigje Nr. 14/01642/tbo-002 Prot, datë 04.06.2014 të Bankës Popullore(Societe Generale Albania), informohemi se: Shtetasi Astrit Uk Nimani ka patur llogari rrjedhëse në lekë hapur në datë 01.01.2008 dhe mbyllur në datë 11.05.2011. Pranë kësaj banke shoqëria "Kalaja IMPEX" shpk ka llogari por rezulton me llogari negative (debitor) në shumën 218 518 lekë. Shtetasit e tjere nuk janë klient të kësaj banke.

-Me shkresën Nr.4612 Prot., dt. 28.05.2014 i është kërkuar informacion Bankës Kombëtare të Greqisë.

Në përgjigje Nr. 006324 Prot, dt 05.06.2014 të bankës Kombëtare të Greqisë, informon se: Shtetasi Astrit Nimani është klient pranë kësaj banke, i cili ka kryer shumë transaksione dhe gjendja aktuale në balancë është 080 Euro.

Shtetasja Elda Nimani është kliente pranë kësaj banke, e cila ka kryer shumë transaksione dhe gjendja aktuale në balancë është 30.34 Euro. Shtetasja Adlie Nimani është kliente pranë kësaj banke, e cila ka kryer shumë transaksione dhe gjendja aktuale në balancë është 352.71 Euro.

Shtetasi Erion Nimani është klient pranë kësaj banke, i cili ka kryer shumë transaksione dhe gjendja aktuale në balancë është 605.91 lekë, 36.81 euro, 4.33 euro.

Shtetasja Ermira Nimani është kliente pranë kësaj banke, e cila ka kryer shumë transaksione dhe gjendja aktuale në balancë është 367 839 lekë dhe 10.028 Euro.

Shoqëria "Kalaja Impex" shpk, ka disa transaksione gjatë viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013 në lekë, euro dhe dollarë, ku balanca e llogarisë sipas përgjigjes së kësaj banke është 3.16 Euro.

Me shkresën Nr. 4559 Prot. datë 27.05.2014 i është kërkuar informacion QKR Tiranë, për bizneset e regjistruara në emër të këtij shtetasi apo familjarëve të tij.

Në përgjigjen e ardhur me shkresën Nr. 3370/2014, datë 03.06.2014, Banka e Kreditit të Shqipërisë, informon se: Astrit NIMANI alias Astrid LIMANI, i biri i Uk dhe i Rushe, i datelindjes 18.04.1971, lindur dhe banues në Lezhë. Shtetasi i mësipërm, figuron të jetë;

- Përfaqësues ligjor dhe ortak me 33% në shoqërine "KALAJA-IMPEX" sh.p.k, regjistruar me Vendim Nr. 3019, datë 14.03.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me numër NIPTI J67902502U.
- Përfaqësues ligjor dhe ortak me 40% në shoqërinë "MARINA SAN GIOVANI" sh.p.k., e regjistruar në QKR, me numër NIPT-I L38006502O.
- Përfaqësues ligjor dhe ortak me 50% në shoqërine "DRITA KONSTRUKSION" sh.p.k., regjistruar me Vendim Nr. 38916, date 20.07.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me numër NIPTI K78228502S.

-I është kërkuar informacion Z.V.R.P.P. Lezhë për pasuritë e paluajtshme të regjistruara në emër të shtetasit Astrit Nimani dhe të familjarëve të tij.

Në përgjigjen me Nr. 1914/01 Prot. datë 10.06.2014 të Z.V.R.P.P Lezhë, informohemi se: Shtetasi Astrit Nimani ka të regjistruar në emër të tij:

Në Z.K. 8631, vol. 7, faqe 209 e 2010 pasuritë 2/10+1-33,34 me sipërfaqe 93.8 dhe 64.9 m2 Uk Ismail Nimani ka regjistruar në emër të tij:

Në Z.K. 8631 vol. 7 faqe 82 pasuritë 4/230 me sipërfaqe 54.7 m2. Adlie Ymer Nimani ka regjistruar në emër të saj:

Në Z.K. 8631 vol. 7 faqe 82 pasuritë 4/230 me sipërfaqe 54.7 m2.

Në këtë përgjigje është thënë se sistemi i të dhënave IPS pasqyron të dhënat deri në korrik të vitit 2013 dhe dhe ndryshimet e bëra pas janarit 2014.

Duke qenë se Zona Kadastrale 3126, e cila përfshin qytetin e Shëngjinit, ku janë indentifikuar në terren, në rrugë operative pasuritë e paluajtshme në emër të shtetasit Astrit Nimani dhe të familjarëve të tij, nga ana jonë u bë kontrolli manualisht i Regjistrave të regjistrimit të pasurive, nga ku rezultuan të regjistruara këto pasuri:

1. Pasuria me nr. 777, e ndodhur në Zonën Kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), volumni X, faqe Y, lloji i pasurisë Hotel-Bar-Restorant me sipërfaqe totale 1940 m2, regjistruar më datën 09.05.2008, në emër të shtetasve Adlije Ymer Nimani, Astrit Uk Nimani e Erjon Uk Nimani, e cila përfshin:

Një godinë 5 katëshe, të ndodhur në qytetin e Shëngjinit, të quajtur "Ermiri Palace" me shërbime Hotel-Bar-Restorant, ku përfshihen kati përdhe me sipërfaqe 416.38 m2, kati I+II me sipërfaqe 460.31 m2, kati IV me sipërfaqe 416.38 m2, kati V me sipërfaqe 186.62 m2.

2. Pasuria me nr. 682, e ndodhur në Zonën Kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), lloji i pasurisë: godinë 11 kate banim + 1 Kat papafingo + 1 Kat Bodrum (Parkim), regjistruar më datën 29.08.2013, në emër të shoqërisë "Kalaja Impex" sh.p.k, ku

figurojnë si ortak shtetasit Adlije Ymer Nimani, Astrit Uk Nimani e Erjon Uk Nimani, e cila përfshin:

Një godinë 11 kate banim + 1 Kat papafingo + 1 Kat Bodrum, të ndodhur në qytetin e Shëngjinit, ku përfshihen:

- Pasuria me nr. 683, Z.K. 3126, kati nëntokë që shërben si parkim me sipërfaqe 391 m2.

- Pasuria me nr. 684, Z.K. 3126, kati përdhe që shërben si njësi tregëtimi, me sipërfaqe 391 m2.

- Pasuritë me nr. 685-750, Z.K. 3126, kati I-XI që shërbejnë si apartamente banimi.

3. Pasuria me nr. 1046, e ndodhur në Zonën Kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), lloji i pasurisë: godinë 8 kate banim + 1 Kat papafingo + 1 Kat Bodrum (Parkim), regjistruar më datën 27.10.2008, në emër të shoqërisë "Kalaja Impex" sh.p.k, ku figurojnë si ortak shtetasit Adlije Ymer Nimani, Astrit Uk Nimani e Erjon Uk Nimani, e cila përfshin: Një godinë 8 kate banim + 1 Kat papafingo + 1 Kat Bodrum (parkim), ku përfshihen:

- Pasuria me nr. 1047, Z.K. 3126, kati nëntokë që shërben si parkim me sipërfaqe 391 m2.

- Pasuria me nr. 1048, Z.K. 3126, kati përdhe që shërben si njësi tregëtimi, me sipërfaqe 575 m2.

- Pasuritë me nr. 1049-1114, Z.K. 3126, kati I-XI që shërbejnë si apartamente banimi.

4. Pasuria me nr. 945, e ndodhur në Zonën Kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), lloji i pasurisë: godinë me 2 Kate njësi tregëtare, 9 kate banim + 1 Kat Pub Panoramik + 1 Kat Bodrum (Parkim), regjistruar më datën 21.10.2008, në emër të shtetasve Astrit Uk Nimani e Eduart Q. Kapri, e cila përfshin: Një godinë 8 kate banim + 1 Kat papafingo + 1 Kat Bodrum (parkim), ku përfshihen:

- Pasuria me nr. 946, Z.K. 3126, kati nëntokë që shërben si garazhe parkimi, me sipërfaqe 865 m2.

- Pasuritë me nr. 947; 948 dhe 1039, Z.K. 3126, që shërbejnë si njësi tregëtimi.

- Pasuritë me nr. 949-1038, Z.K. 3126, kati II-XI që shërbejnë si apartamente banimi.

Ky veprim u dokumentua me procesverbal kqyrje marrje prove materiale të datës 11.04.2015 dhe u shoqërua me marrjen si provë materiale të dokumentacionit (fotokopje) të njësuar me origjinalin.

Me shkresën Nr. 45555 Prot. datë 27.05.2014 i është kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, për bizneset e regjistruara në emer te shtetasit Astrit NIMANI alias Astrid LIMANI dhe familjarëve të tij.

Në përgjigje nr. 3541/2 Prot, datë 16.06.2014 rezulton se shtetasi Astrit Nimani është ortak në shoqërinë "Kalaja" sh.p.k. me nr. NIPT-i J67902502U me 33.30% të aksioneve të shoqërisë.

Shtetasi Uk Nimani ka qënë administrator dhe ortak i kësaj shoqërie ku sipas të dhënave të nxjerra nga QKR më datë 08.09.2005 pas vdekjes është bërë çelja e dëshmisë së trashëgimisë.

Shtetasja Adlije Nimani është ortak në shoqërinë “Kalaja” Shpk me nr.NIPTI J67902502U me 33.30% të aksioneve të shoqërisë.
Shtetasi Erjon Nimani është ortak në shoqërinë “Kalaja” Shpk me nr.NIPTI J67902502U me 33.40% të aksioneve të shoqërisë.

Shoqëria “Kalaja” sh.p.k, ka NIPTI J67902502U, me adresë kryesore të zhvillimit të aktivitetit tregëtar: Shëngjin, lloji i aktivitetit “Hotel, ndërtim, Bar-Restorant”, data e fillimit të aktivitetit 01.07.1996, Kod Fiskal 2100508, pronësia shqiptare-private, Statusi ligjor sh.p.k, Dega e regjistrimit, Lezhë, Tatimet për të cilat është regjistruar janë TVSH, Tatim fitimi, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (kategoria punëdhënës) dhe të ardhura nga punësimi.

Vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë sipas QKR janë:

1-Shëngjin, objekti shtesë 3 kate mbi objektin ekzistues 4 katësh, në Shëngjin, në pronësi të shtetasit Leonard Kondakçi.

2-Tiranë, Farkë, Sauk, objekt godinë banimi 3 dhe 4 kat me nënçati dhe dy kate nën tokë.

3-Shëngjin, Ishull-Shëngjin, Lagjia “Kune”, objekti godinë 4 kate, një kat Bar-Restorant dhe tre kate hotel.

Shoqëria “Kalaja” sh.p.k me nr. NIPT-i J67902502U ka detyrime tatimore nga D.R.T, Lezhë në shumën 96 437 lekë (TVSH shuma 23 909 lekë, tatim fitimi shuma 22 528 lekë dhe të tjera (pa tatim) shuma 50 000 lekë.

Me shkresën Nr. 45556 Prot., datë 27.05.2014 i është kërkuar informacion ALUIZNI-t Lezhë, për shtetasin, Astrit NIMANI *alias* Astrid LIMANI dhe familjarët e tij.

Në përgjigjen e ardhur me Nr. 455 Prot. datë 03.06.2014 rezulton se shtetasit e lartpërmendur nuk kanë aplikuar pranë këtij institucioni per legalizimin e ndonjë objekti informal.

Me shkresën Nr. 4551 Prot., datë 27.05.2014 i është kërkuar informacion DRSHTRR, Kurbin, për shtetasin, Astrit NIMANI *alias* Astrid LIMANI dhe familjarët e tij.

Në përgjigjen e ardhur Nr. 788/1 Prot, datë 03.06.2014 rezulton se:

Shtetasi Erjon Nimani ka të regjistruara mjetet me targa AA777CH dhe AA090BI, ku bashkëlidhur janë kopjet e karakteristikave të mjeteve.

Me shkresën Nr. 4552 Prot., datë 27.05.2014 i është kërkuar informacion QKR, për shtetasin, Astrit NIMANI *alias* Astrid LIMANI dhe familjarët e tij.

Me shkresën Nr. 4553 Prot., datë 27.05.2014 i është kërkuar informacion QKL, për shtetasin, Astrit NIMANI *alias* Astrid LIMANI dhe familjarët e tij.

Në përgjigje të këtij institucioni sqarohet se nuk kanë aplikuar për tu pajisur me liçensë.

Cila është veprimtaria penale apo vepra penale, nga e cila dyshohet se kanë buruar të ardhurat e paligjshme dhe si janë integruar duke i justifikuar si të ardhura të ligjshme.

Veprimtaria kriminale në shtetin italian ku dyshohet se kanë buruar të ardhurat të cilat janë integruar në: prona të paluajtshme, të luajtshme, llogari bankare, biznese.

Me shkresën Nr. 3095 Prot. datë 28.05.2014, i është kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informatikës, Tiranë për shtetasin, Astrit NIMANI.

Në përgjigje të institucionit të mësipërm datë 31.03.2014 rezulton se shtetasi i lartpërmendur është i padënuar në shtetin shqiptar.

Cila është forma dhe mekanizmi i përdorur për integrimin e tyre.

- Forma dhe mekanizmi i përdorur për integrimin e tyre janë:*
- Çelja e llogarive bankare ne shuma të mëdha në emër të tij dhe familjarëve të tij;*
- Krijimi i aktiviteteve private në emër të tij dhe familjarëve të tij, kryesisht në fushën e ndërtimit;*
- Blerja e automjeteve luksoze në emër të tij dhe familjarëve të tij;*
- Investimi në biznese në fushën e ndërtimit, të regjistruara në emër të tij dhe familjarëve të tij, të cilat nuk justifikohen me të ardhurat legale që ky shtetas ka siguruar nga bizneset e ligjshme.*

Kush është burimi i të ardhurave në mënyrë kronologjike kohore dhe si janë justifikuar në kuptimin ekonomik, duke investuar në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në emër të tij apo familjarëve.

Burimi i të ardhurave dyshohet se janë siguruar nga veprimtaria kriminale e shtetasit Astrit NIMANI alias Astrid LIMANI në shtetin italian dhe konkretisht nga kryerja e veprës penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike, e kryer në bashkëpunim", bazuar në përgjigjet e përmendura më lart, të ardhura nga Zyra Ndërlidhëse e Policisë Italiane me Shqipërinë, Interforce, Tiranë dhe Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana.

Sa më sipër, të gjitha faktet e provuara deri tani mbështesin dyshimin se pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, si dhe vlerat monetare të konsiderueshme të depozituara dhe të qarkulluara në banka, janë krijuar mbi bazën e të ardhurave të siguruara nga aktiviteti kriminal i shtetasit Astrit Nimani, pra, pasuritë dhe shumat e qarkulluara në llogari bankare mund të jenë produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike të kryer nga shtetasi Astrit Nimani. Kjo duke pasur parasysh aktivitetin kriminal të këtij shtetasi, shumat e mëdha të investuara për blerje të pasurive të paluajtshme e të luajtshme apo në bizneset e ndërtimit, shumat e mëdha të depozituara në banka dhe transaksionet e kryera me ato, të cilat nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike sepse nuk identifikohen burime të ligjshme të ardhurash për të siguruar këto pasuri, pasi dhe ushtrimi i aktiviteteve tregëtare të regjistruara ka ndodhur pas vendosjes së pasurive të përmendura

më sipër, transaksionet e kryera midis shtetasve Astrit Nimani dhe personave të tjerë tek pasuritë e paluajtshme, si dhe të gjitha këto veprime pasurore rezultojnë se janë kryer afersisht në të njëjtën periudhë kohore midis tyre dhe aktivitetin kriminal për të cilin dyshohet shtetasi Astrit Nimani.

Në këto rrethana, duke qene se në rastin konkret pasuritë e paluajtshme në emër të shtetasit Astrit NIMANI *alias* Astrid LIMANI dhe familjarëve të tij, dyshohet se janë produkte të veprave penale ose i veprimtarisë kriminale, si dhe ka rrezik qe disponimi i lire i tyre mund te rendojë pasojat e vepres penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal, duke u tjetërsuar ose transferuar, bazuar ne nenin 274, paragrafi 1 e 2 të Kodit të Procedures Penale:

K È R K O J

1. Vendosjen e sekuestros preventive për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të identifikuara deri tani, duke urdhëruar sekuestrimin e:

Pasurive të paluajtshme:

- *Pasuria me nr. 777, e ndodhur në Zonën Kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), volumi X, faqe Y, lloji i pasurisë Hotel-Bar-Restorant me sipërfaqe totale 1940 m2, regjistruar më datën 09.05.2008, në emër të shtetasve Adlije Ymer Nimani, Astrit Uk Nimani e Erjon Uk Nimani, e cila përfshin:*
- *Një godinë 5 katëshe, të ndodhur në qytetin e Shëngjinit, të quajtur "Ermiri Palace" me shërbime Hotel-Bar-Restorant, ku përfshihen kati përdhe me sipërfaqe 416.38 m2, kati I+II me sipërfaqe 460.31 m2, kati IV me sipërfaqe 416.38 m2, kati V me sipërfaqe 186.62 m2.*
- *Pasuria me nr. 682, e ndodhur në Zonën Kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), lloji i pasurisë: godinë 11 kate banim + 1 Kat papafingo + 1 Kat Bodrum (Parkim), regjistruar më datën 29.08.2013, në emër të shoqërisë "Kalaja Impex" sh.p.k, ku figurojnë si ortak shtetasit Adlije Ymer Nimani, Astrit Uk Nimani e Erjon Uk Nimani, e cila përfshin:*
- *Një godinë 11 kate banim + 1 Kat papafingo + 1 Kat Bodrum, të ndodhur në qytetin e Shëngjinit, ku përfshihen:*
- *Pasuria me nr. 683, Z.K. 3126, kati nëntokë që shërben si parkim me sipërfaqe 391 m2.*
- *Pasuria me nr. 684, Z.K. 3126, kati përdhe që shërben si njësi tregëtimi, me sipërfaqe 391 m2.*
- *Pasuritë me nr. 685-750, Z.K. 3126, kati I-XI që shërbejnë si apartamente banimi.*
- *Pasuria me nr. 1046, e ndodhur në Zonën Kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), volumi X, faqe Y, lloji i pasurisë: godinë 8 kate banim + 1 Kat papafingo + 1 Kat Bodrum (Parkim), regjistruar më datën 27.10.2008, në emër të shoqërisë "Kalaja Impex" sh.p.k, ku figurojnë si ortak shtetasit Adlije Ymer Nimani, Astrit Uk Nimani e Erjon Uk Nimani, e cila përfshin: Një godinë 8*

kate banim + 1 Kat papafingo + 1 Kat Bodrum (parkim), ku përfshihen:

- Pasuria me nr. 1047, Z.K. 3126, kati nëntokë që shërben si parkim me sipërfaqe 391 m².
- Pasuria me nr. 1048, Z.K. 3126, kati përdhe që shërben si njësi tregëtimi, me sipërfaqe 575 m².
- Pasuritë me nr. 1049-1114, Z.K. 3126, kati I-XI që shërbejnë si apartamente banimi.
- Pasuria me nr. 945, e ndodhur në Zonën Kadastrale 3126 (në qytetin e Shëngjinit), lloji i pasurisë: godinë me 2 Kate njësi tregëtare, 9 kate banim + 1 Kat Pub Panoramik + 1 Kat Bodrum (Parkim), regjistruar më datën 21.10.2008, në emër të shtetasve Astrit Uk Nimani e Eduart Q. Kapri, e cila përfshin: Një godinë 8 kate banim + 1 Kat papafingo + 1 Kat Bodrum (parkim), ku përfshihen:
- Pasuria me nr. 946, Z.K. 3126, kati nëntokë që shërben si garazhe parkimi, me sipërfaqe 865 m².
- Pasuritë me nr. 947; 948 dhe 1039, Z.K. 3126, që shërbejnë si njësi tregëtimi.
- Pasuritë me nr. 949-1038, Z.K. 3126, kati II-XI që shërbejnë si apartamente banimi.

PROKURORI
Erjon SHEHAJ

